

(FORMULARI TIP I KERKESES PER KONSULTIMIN ME PUBLIKUN)

Date: 21 / 01 / 2017

Lenda: Kerkese per terheqje te formularit per konsultimin me publikun

Drejtuar: Agjensise Kombetare te Mjedisit
Drejtorese se Vleresimit Mjedisor

Une i nenshkruari Tomi ISMAILATI, perfaqesues i Shoqerise "ARTIC GROUP" Sh.p.k ne kuader te organizimit te konsultimit me publikun, ne lidhje me **Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis** (Formular Kerkese Tipi B) te aktivitetit qe kryen Shoqeria jone, bej kete kerkese per terheqje te formularit tip kerkese, bazuar ne VKM Nr. 247, Date: 30.04.2014, "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimarrjen mjedisore" dhe Urdherit Nr. 78, Date 14.05.2014 te Drejtorit te Pergjithshem te AKM-se.

Me poshte gjeni te dhena lidhur me shoqerine dhe aktivitetin qe ajo kryen:

- Shoqeria: "ARTIC GROUP" Sh.p.k
- Perfaqesuesi: **Tomi ISMAILATI**
- Aktiviteti: **PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITE E LIDHURA ME TO, PIKA 7.7/f. TRAJTIMI OSE MAGAZINIM I PESHQEVE TE NGORDHUR OSE MBETJEVE TE PESHQEVE.**
- Vendodhja: **FSHATI XHAFZOTAJ, AUTOSTRADA DURRES-TIRANE, PRANE MBIKALIMIT TE FLLAKES, NJESIA ADMINISTRATIVE XHAFZOTAJ, ZONA KADASTRALE 2574, NR. PASURIE 159/79, DURRES**

Kontak: Tel / email..... +355 68 216 5101

Duke Ju falenderuar per bashkepunimin,

Perfaqesuesi i Shoqerise
(Tomi ISMAILATI)



SHOQERIA "ARTIC GROUP" Sh.p.k.

AKTIVITETI: PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITE E LIDHURA ME TO, PIKA 7.7/f. TRAJTIMI OSE MAGAZINIM I PESHQEVE TE NGORDHUR OSE MBETJEVE TE PESHQEVE.

PERMBLEDHJE NE GJUHE JO-TEKNIKE

AKTIVITETI: Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to, pika 7.7/f. Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve.

VENDNDODHJA: Fshati Xhafzotaj, Autostrada Durres-Tirane, prane mbikalimit te Fllakes, Njesia Administrative Xhafzotaj, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurie 159/79, Durres



Bazuar ne Ligjin 60/2014 Shtojca I "Per Lejet e Mjedisit" aktiviteti: Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to, pika 7.7/f. Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve.

Referuar Vendimit Nr. 419, date 25.6.2014, Kreu II Procedrat per shqyrtimin e kerkesave dhe percaktimi i kushteve per leje mjedisi te Tipit B, pika 1.dh Shoqeria "ARTIC GROUP" Sh.p.k. aplikon per zhvillimin e procesit te degjeses me publikun, sipas pikes 13 te kreut VI te ketij vendimi.

Shoqeria "ARTIC GROUP" Sh.p.k.

Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise

Tomi ISMAILATI



PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

Shoqeria "ARTIC GROUP" Sh.p.k. aplikon per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B, per impiante dhe instalime te reja, referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te Ligjit Nr. 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit" Shtojca 1 (e ndryshuar) **Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtarite e lidhura me to, pika 7.7/f. "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve".**

Ne Aktivitet jane te punesuar 13 punonjes. Aktiviteti eshte instaluar ne siperfaqen e tokes dhe godines ne pronesi te z.Edmond Dako dhe marre me qera nga **Shoqerise "ARTIC GROUP" Sh.p.k.**

AKTIVITETI: "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve".

Adresa: Fshati Xhafzotaj, Autostrada Durres-Tirane,
prane mbikalimit te Fllakes, Njesia Administrative Xhafzotaj,
Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurie 159/79, Durres

Subjekti: "ARTIC GROUP" Sh.p.k.

NIPTI L 61518501 B

Administrator: z. Tomi Ismailati

Celular 355 672002803

1. Hyrje

Profili i Shoqërisë "ARTIC GROUP" Sh.p.k. me Aktivitet "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve".

Instalimi "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve"per Shoqërinë "ARTIC GROUP" Sh.p.k. është i vendosur ne te djathte te Autostrades Durres - Tirane, Fshati Xhafzotaj,Njesia Administrative Xhafzotaj, Durres. Kjo Shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për kryerjen dhe marrjen pjese ne te gjitha aktivitetet qe mund te ushtrojne ne baze te legjislacionit Shqiptar,dhe ne veçanti: Tregëtia, me shumice dhe pakice, importi –ekporti, prodhimi, perpunimi, ruajtja, logjistika, shperndarja, levizja dhe depozitimi, per vete dhe per llogari te te treteve, i te gjitha llojeve te produkteve te ngreneshme, krustaceve, molusqeve dhe frutave te detit, si dhe produkteve te tjera ushqimore, qe jane te fresketa, te ngrira, te stazhonuara, ne vakum, te pjekura, te pagatuara ose te pregatitura. -Hapja dhe administrimi i minimarketeve, supermarketeve, bare, restorante, sherbim self-servise, piceri, berrari, pabe, hotele, objekte banje ose plazhe, jo vetem per manaxhinm ose eprdorim per aktivitetin po dhe per dhenie franchising ose lloje te tjera dhenie ne perdorim.; -Tregëtia, import-eskporti, rritja, perpunimi i te gjitha llojeve te peshkut, krustaceve dhe molusqeve tne pergjithesi, perlllogari te veta ose per llogari te te treteve; -Ushtrimi i aktivitetit te agjensise se perfaqesimit, me dhe pa depozite, te konsulences dhe te sherbimeve per shoqerite ose individet operuese ne sektoret e permenduar sa me siper; -Hapja dhe ushtrimi i aktiviteteve industriale dhe tregëtare qe operojne ne sektorin ushqimor ne pergjithesi; - Sherbime transporti per llogari vetiake ose

per llogari te te treteve; -Blerja, dhenia me qera, marrja ne zoterim permes kontratave leasingut financiar si dhe shitja e makinerive dhe paisjeve per llogari te njesive te manaxhuara ose per shoqerite per te cilat kryhen keto sherbime; Ajo mund të 2 kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, mobiliare, imobiliare të konsideruara si të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, duke saktësuar se aktiviteti financiar mund të kryhet vetëm me qëllim realizimin e objektit të shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të blejë kuota në ndërmarrje apo Shoqëri. Për përmbushjen sa më të mirë të objektit të shoqërisë, në rend të dytë dhe jo si qëllim ekskluziv apo predominues, Shoqëria mundet të japë dhe të marrë fidejusionë, garanci, dhe kapar.

Shoqëria "Artic Group" Sh.p.k u krijua ne mars te vitit 2016 si nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizur ne perputhje me legjislacionin Shqiptar per Sh.p.k-te. Shoqëria është me partneritet Shqiptar dhe Italian dhe kryesisht pjesa me e madhe e aktivitetit është e lidhur me keto dy shtete. Ne mars te viti 2016 Shoqëria "Artic Group" Sh.p.k. regjistrohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Bizneseve dhe pas disa muajsh ne korrik te vitit 2016 Shoqëria "Artic Group" fillon aktivitetin normal te tij, pra procesin e perpunimit te produkteve te ngrira te importuara te peshkut. Shoqëria zoteron te gjitha licencat nga Autoritetet Kombetare te Ushqimit qe i mundesojne asaj te kryeje nje aktivitet normal dhe te suksesshem. Bazuar ne shkallet e cikleve te biznesit mund te themi se Shoqëria është tashme ne fazen e pare te hyrjes ne treg dhe pak nga pak po shkon drejt fazes se rritjes pas realizimit te eskporteve te para si dhe shitjeve brenda vendit.

Shoqëria është me **Nr. NIPT: L 61518501 B**. Objekti ku është vendosur instalimi per "**Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve**", është ekzistues, i ndertuar sipas parametrave urbanistike dhe teknik. Hapsirat e brendshme te objektit jane te mjaftueshme per zhvillimin e aktivitetit dhe levizjen e lire te mjeteve dhe punonjesve.

Aktiviteti ka nje **siperfaqe prej 510 m²**, dhe ka te gjitha hapesirat e nevojshme per kete aktivitet duke shfrytëzuar te gjitha ambjentet per kete aktivitet. Siperfaqja e pergjithshme e prone është 3950 m² dhe është ne pronesi te z. Edmond Dako.

Informacion mbi Shoqerine "ARTIC GROUP" Sh.p.k.

Shoqëria "**ARTIC GROUP**" Sh.p.k. është nje Sùbjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e "**Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve**", Qellimi i Shoqërisë ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise se produkteve qe ajo do te trajtoj, dhe per kete Shoqëria ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e parametrave teknik dhe higjenik ne te gjitha hallkat e aktivitetit.

Fusha ne te cilen ne ushtrojme aktivitetin ben qe te mos hasim disa veshtiresi te ambientit te afert rrethues siç mund t'i kene Subjekte qe operojne ne aktivitete te tjera. Ose me mire te themi ndikimi i tyre është shume i ulet. Kjo per shkak se baza e aktivitetit dhe produktit tone jane produktet e ngrira te detit, ne ndryshim nga konkurrentet te cilet bazohen kryesisht ne produkte te sapo peshkuara. Gjithashtu menyra e paketimit dhe nderthurjes se tij është nje risi ne tregun Shqiptar.

Klientet tane i perkasin kryesisht tregut te huaj, pra jo atij brenda territorit te Shqiperise. Por sigurisht qe Shoqëria është e hapur dhe mirepret te gjitha kerkesat ndaj klienteve dhe konsumatoreve Shqiptar. Kryesisht produktet perfundimtare te eksportuara shkojne drejt kompanise sone kryesore italiane furnitore e cila është ne te njejten kohe edhe klienti yne kryesor. Kjo kompani siguron tregun tone nderkombetar per riekportim ne shtete te ndryshme te botes.

Ka edhe disa kompani te tjera ne territorin e Shqiperise, kryesisht ne segmentin Durrës-Tiranë, qe ushtrojne te njejtin aktivitet me ne, por s'mund t'i konsiderojme konkurrencte me ndikim. Kjo sepse secili

prej tyre eshte perqendruar ne nje segment tregu te percaktuar, ne nje target klientesh te tijin pa e penguar ne menyre te ndjeshme aktivitetin e tjetrit.

Per kete qellim, subjekti **"ARTIC GROUP" Sh.p.k.** referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" ka plotësuar Formularit e Kërkeses per tu pajisur me Leje Mjedisit te Tipit B per aktivitetin **"Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve"**, ne Fshati Xhafzotaj, **Autostrada Durres-Tirane, prane mbikalimit te Fllakes, Njesia Administrative Xhafzotaj, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurie 159/79, Durres.**

Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendosja e ketij Aktiviteti ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjeticke, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve për perballimin e kerkesave te sektorit familjar dhe bizneseve te ndryshme.

2. Të dhëna mbi Aktivitetin e instaluar

Shoqeria **"ARTIC GROUP" Sh.p.k.** me administrator **z.Tomi Ismailati**, ka si aktivitet kryesor **"Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve"**,

Me poshte do te tregojme shkurtimisht procesin e punes dhe metodave qe

Shoqeria **"ARTIC GROUP" Sh.p.k.** kryen.

Shoqeria **"ARTIC GROUP" Sh.p.k.** ka filluar aktivitetin qe ne mars te vitit 2016.

Siperfaqja e ambienteve ku Shoqeria ushtron aktivitetin eshte **510 m2**.

Brenda kesaj siperfaqe jane instaluar:

- Magazine
- Frigorifer i Vogel
- Frigorifer i madh
- Ambjente sherbimi
- Ambjenti i punes se punonjesve
- Zyra,
- Dhoma e zhveshjes se punonjesve
- Dhoma e mjekut
- Ambjente higjenike

Objekti sherben per Aktivitetin **"Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve"** ne te njejten kohe kryhen operacionet si:

1. Magazinimi i arkave me peshq
2. Shkrirja e produkteve te detit
3. Pastrimi i produkteve te detit
4. Prerja dhe perpunimi produktit
5. Paketimi i produktit
6. Ngrirja e produktit
7. Ruajtja ne frigorifer gati per tregtim

Ne Aktivitet perpunohen produktet e meposhtme:


- Kallamaret
- Karkalecat
- Sepiet
- Oktapodet etj

Me skeme funksionimi Aktiviteti si me poshte:

Ne procesin e punes te kompanise sone te biznesit perfishihen produktet e ndryshme te peshkut, te emertuara ndryshe si frutat e detit, ku bejne pjese : kallamaret, karkalecat, sepjet, oktapodet etj. Keto produkte merren nga importi si lende e pare te ngrira dhe te papastruara.

Fillimisht i nenshtrohen procesit te shkrirjes dhe me pas realizohet pastrimi i tyre, gjate se cilit humbasin nje pjese te konsiderueshme te peshes. Pas procesit te pastrimit i cili realizohet nje pjese me ane te makinerive qe jane ne perdorim dhe nje pjese nga grupi i punetoreve te fabrikes duke perdorur mjete te ndryshme pune dhe uje te rrjedhshem, kalohet ne procesin e perpunimit te produktetve gjysme te gatshme per te realizuar produktin perfundimtar. Ne kete proces behet prerja sipas nje formati te caktuar dhe vendosja e produkteve te peshkut te pastruara ne paketime te vecanta ne forme vasketash te cilat mund te jene te madhesive te ndryshme, te vogla, te mesme ose te medha, pra te peshave te ndryshme, ose mund te realizohen produkte te tipit spiedin duke perdorur shkopinj te holle prej druri te vecante te cilet kane ne brendesi nje pjese karkaleca dhe nje pjese kallamare te prera sipas formave te vecanta. Pasi finalizohet mbushja e spiedinit dhe vasketave me kallamare, sepje, karkalece dhe oktapode kalohet ne procesin e ngrirjes se tyre duke realizuar disa banja me uje ne menyre qe te fitohet nje pjese e peshes se humbur nga pastrimi. Niveli i akullit ne brendesi te produktit mund te arrije 10%-15%. Produkti para se te paktohet ne formatin perfundimtar ne kartona me peshe 3 kg ose 8 kg ruhet ne frigorifere ne nje temperature konstante ne perputhje te plote me standartet e Bashkimit European mbi ruajtjen dhe paketimin e ushqimit. Te gjitha produktet krijohen me qellimin per tu eksportuar ne vendet e Bashkimit European e me tej ne te gjitha boten dhe ne kete menyre procesi i pastrimit, perpunimit dhe paketimit eshte ne perputhje te plote dhe ne zbatimit te rregullave dhe kushteve te higjenes dhe konsumit. Fabrika perpunon sasi te medha produkti qe arrin deri ne 20 ton ne muaj dhe per cdo lloj produkti qe vjen nga importi dhe me pas perpunohet e del nepermjet eksporti realizohen analizat perkatese per te vertetuar permbushjen e standarteve te konsumit.

Shoqeria "ARTIC GROUP" Shp.k. ka marre te gjitha masat per zbatimin e kushteve teknike dhe higjenike per zhvillimin e ketij aktiviteti.



2.1 Pershkrim i pergjithshem

Kompania jone ushtron aktivitetin ne industrine ushqimore, konkretisht ne perpunimin e produkteve te importuara te peshkut. Produktet e ngrira te peshkut ne te cilat bejne pjese kallamaret, karkalecat, sepiet, oktapodet te cilat jane peshkuar ne dete dhe oqeanet ne mbare boten nepermjet kompanise kryesore furnitore vijne ne kompanine tone ne Shqiperi, ku i nenshtrohen procesit te manipulimit per tu bere gati per tu eksportuar jashte vendit. Pra qellimi i ketij aktiviteti biznesi eshte te ofroje nje produkt te importuar ne gjendje pothuajse gjysem te gatshme per tu konsumuar nga klientet. Baza e produktit perfundimtar te gatshem per shitje jane kallamaret dhe karkalecat me te cilat realizohet mbushja e kartonave ne vasketa dhe spiedini. Produktet paketuese permbushin standardet europiane te cilesise se prodhimit. Gjithashtu vlen te theksohet se gjithe linja e procesit te manipulimit te produktit, pra shkrirjes se lendes se pare, pastrimit, larjes dhe me pas paketimit ne vasketa, spiedini dhe kartona eshte ne konformitet te plote me standardet europiane te kesaj industrie.

Furnizimi dhe shperndarja e lendeve energjetike

Per sigurimin e funksionimit te pajisjeve matese dhe te kontrollit ne objekt, duhen burimet energjetike te meposhtme:

- Energji elektrike
- Ajer i ngjeshur

Shkalla e automatizimit

Kjo shkalle eshte e dukshme gjate pershkrimit teknik te njesise dhe specifikimeve te tyre teknike.

Simbolet grafike

Simbolet grafike dhe emertimi (etike Umi) i instrumenteve jane ne perputhje me ISA-S 5.1. Emertimi i instrumenteve eshte ne perputhje me praktikat standarde te projektimit dhe sipas kerkeses se investitorit.

Njesite matese

Njesite matese jane perdorur ne perputhje me sistemin SI :

- temperatura : °C, °K
- pesha g,Kg.
- trysnia: kPa, Pa, mm²/s,

Instalimi i pajisjeve ne zonat e rrezikshme

Te gjitha instalimet dhe instrumentet elektrike projektuar per tu montuar ne zonat e rrezikshme te objektit, jane ne planin e mbrojtjes nga eksplozioni.

Karakteristikat e sistemit te instrumenteve

Llojet e sinjaleve

Sinjalet e instrumenteve jane zona standard dhe jane:

- sinjalet elektrike:
- impulse,digjitale ose analoge 4-20 mA
- transmetimi serial RS 422, RS 485

Protokolli per transmetimin e sinjaleve sipas specifikimit te ofruesve per pjese te vecanta te pajisjeve.

Materiali per instalim eshte ne perputhje me praktikat per kete lloj Aktiviteti.

Ne materialin instalues jane perfshire artikuj si: Kabina e kontrollit te frigoriferave, kabllot,sistemuesit e kablllove, pengesat e brendshme te sigurimit, etj.

2.3 Furnizimi i energjise

Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike i instrumenteve eshte 230 V, 50 Hz.

Në varësi të llojit të impiantit dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti në të gjitha ambjentet e tyre janë pajisur me kasetë të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Furnizimi Pneumatik

Ajri i ngjeshurperkontrollin e valvulave duhet te kete shtypjen minimale 7 bar, me pike lageshtie -28 °C.


- Hyrja, Zyra, Parking

Pjese perberese te Shoqerise jane dhe rruga per ne aktivitet, zyra ku kryhen veprimet ekonomike financiare te Shoqerise dhe parking i automjeteve.

- Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme

Objekti lidhet me **Autostraden Durres - Tirane**, e cila mundeson komunikimin me Kompanine ne nje distance prej 50 m larg Mbikalimit te Fllakes, çka ben te mundur qe ky Aktivitet te mos ndikojte ne trafikun e zones. Rruga e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjendje mjaft të mire e shtruar me asfalt dhe e niveluar sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke mundesuar levizjen e lire te mjeteve te transportit. Gjithashtu pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Planvendosja e impiantit e paraqitur në ortofoto.



Kordinatat e objektit ku zhvillohet aktiviteti		
Pikat	X	Y
1	459132.41	4579191.27
2	459174.74	4579213.84
3	459148.45	4579168.82
4	459185.41	4579195.45

Distanca e Aktivitetit te Subjektit "ARTIC GROUP " Sh.p.k. nga objektet/veprat më të afërta

Drejtimi	Objekti	Distanca	Aktiviteti
Veri	Objekti më e afërt	60m	Toke e lire,shtepi banimi
Jug	Objekti më e afërt	0 m	Kapanon Industrial
Lindje	Objekti më e afërt	20 m	Kapanon Industrial
Perëndim	Objekti më e afërt	40 m	Kapanon Industrial

Kondicionet urbanistike të objektit, janë si më poshtë:

Emri i Tregtar	"ARTIC GROUP"Sh.p.k.
Sipërfaqja ku zhvillohet aktiviteti	510 m²
Veprimtaria	"Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve"
Statusi shoqërisë	Aktiv
Vendodhja e Aktivitetit	Fshati Xhafzotaj, Autostrada Durres-Tirane, prane mbikalimit te Fllakes, Njesia Administrative Xhafzotaj, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurie 159/79, Durres.

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin Subjekti "ARTIC GROUP" Sh.p.k. nuk ka shkolla, vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë dhe linjë uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit për "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve"

3. Menaxhimi i Aktivitetit

Menaxhimi i Aktivitetit behet nga nje staf i kualifikuar dhe trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar aktivitetin e per "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve" te cilin Shoqeria "ARTIC GROUP" Sh.p.k. operon ne tregun e huaj. Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj Shoqeria konform te gjitha rregullave, teknike, tatimore, fiskale dhe atyre mjedisore, eshte organizuar puna ne menyre te tille qe te funksionojne ne formen e nje organogrami per realizimin sa me eficient dhe te sukseshem, e cila tregon menyren e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe pergjegjesive te secilit.

Prodhimi perfaqesohet nga inxhinier teknologje ushqimore dhe specialist te specializuar ne perdorimin e paisjeve, te trajnuar per mirefunksionimin e tyre dhe shfrytezimin efficient te tyre. Ne procesin e punes te kompanise sone te biznesit perfshihen produktet e ndryshme te peshkut, te emertuara ndryshe si frutat e detit, ku bejne pjese : kallamaret, karkalecat, sepjet, oktapodet etj. Keto produktet merren nga importi si lende e pare te ngrira dhe te papastruara. Fillimisht i nenshtrohen procesit te shkrirjes dhe me pas realizohet pastrimi i tyre, gjate se cilit humbasin nje pjese te konsiderueshme te peshes. Pas procesit te pastrimit i cili realizohet nje pjese me ane te makinerive qe jane ne perdorim dhe nje pjese nga grupi i punetoreve te fabrikes duke perdorur mjete te ndryshme pune dhe uje te rrjedhshem, kalohet ne procesin e perpunimit te produktetve gjysme te gatshme per te realizuar produktin perfundimtar. Ne kete process behet prerja sipas nje formati te caktuar dhe vendosja e podukteve te peshkut te pastruara ne paketime te vecanta ne forme vasketash te cilat mund te jene te madhesive te ndryshme, te vogla, te mesme ose te medha, pra te peshave te ndryshme, ose mund te realizohen produkte te tipit spiedin duke perdorur shkopinj te holle prej druri te vecante te cilet kane ne brendesi nje pjese karkaleca dhe nje pjese kallamare te prera sipas formave te vecanta. Pasi finalizohet mbushja e spiedinit dhe vasketave me kallamare, sepje, karkalece dhe oktapode kalohet ne procesin e ngrirjes se tyre duke reliazuuar disa banja me uje ne menyre qe te fitohet nje pjese e peshes se humbur nga pastrimi.

Financa eshte department i cili perfaqesohet nga studio ligjore e nenkontraktuar dhe nga ekonomist te brendshem ne kalkulimet dhe ruajtjet e sakta te informacionit kontabel. Magazinimi perfaqesohet nga shefi i magazines me asistentet e tij, ndersa mirembajtja e paisjeve dhe frigoriferve behet nga teknik i specializuar ne kete fushe.

Përbërësit kryesorë të këtij programit per menaxhimin e mjedisit do të ndërthuren si më poshtë:

- Informacion i përgjithshëm;
- Mirëkuptim i informacioni të përgjithshëm i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsyet për një menaxhim mjedisor të mirë;
- Përdorimi i pajisjeve/aparatura të Certifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave nga ekspertë të specializuar.
- Respektimi i orareve të punës brenda zonës ku zhvillohet veprimtaria
- Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.
- Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga kompani të licensuara
- Trajtim i ujrave teknologjike te gjeneruara nga instalimi
- Zhurmat do të jenë të përkoshme dhe tepër të ulëta duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, sipas Udhëzimit Nr.8, dt 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".
- Mirëkuptimi i potencialit të ndikimeve ambientale, që mund të priten nga faza kryesore e zhvillimit të aktivitetit;

- Funksionimi;
- Arsyet për propozimin e masave zbutëse;
- Vendosja në zinxhir e përgjegjëse dhe vendim marrja;
- Trajnime specifike;
- Monitorimi i cilësisë ajrit;
- Monitorimi i cilësisë ujrave;
- Kriteri për vendosjen e stacioneve monitoruese;
- Metodologjitë që duhen përdorur për fushën e marrjes së mostrave;
- Trajnime në përdorimin e pajisjes dhe teknikat korrekte për ruajtjen e mostrës;
- Trajnim në laborator dhe rëndësia e cilësisë së sigurisë dhe metodat e kontrollit të cilësisë;
- Trajnim në gjetjen e mospërputhjes së situatave dhe procedurat që duhen ndjekur;
- Kërkesat e mjeteve që do t'ju kryhet shërbimi;



Pamje e produktit të detit që vjen nga importi

3.1 Menaxhimi i paisjeve në aktivitet


Për mbrojtjen e paisjeve nga bllokimi apo avaritë e ndryshme teknike rënia nën tension, rënia e zjarrit, bllokimi i paisjeve nga papastërtitë e lëndës së pare, lëvizja e punonjësve dhe mjeteve të transportit të brendshëm, etj janë marre keto masa:

- Percaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.

- Eshte instaluar sistem i ujitjes per mjedisin perreth (varet dhe nga hapesira e planifikuar per gjelberim si dhe pozicioni qe ato kane) si dhe lagia me uje e rrugicave te brendshme gjate periudhes Maj-Tetor, ujrat e pastrimit do të shkarkohen në rrjetin e brendshëm të kullimit dhe nga aty në vasken e dekantimit, këto ujra nuk janë të ndotura më lëndë me përbërje të rrezikshme.
- Brenda objektit kryhet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat jene; lende te aballazheve, letra-kartona, si dhe lende organike te gjeneruara nga punonjesit, keto mbetje grumbullohen dhe periodikisht depozitohen ne vendin e caktuar nga Njësia Vendore ku jane vendosur kosha selektive. Mbetjet e ngurta urbane te gjeneruara, depozitohen ne kosha brenda territorit te shoqerise me volum 0.5 m^3 prej ku me pas merren nga mjetet e shoqerise dergohen ne koshat e perbashket, nga ku me pas mjetet e pastrimit te Bashkise i dergojne ne vendepozitimn e caktuar prej tyre. Sasia e mbetjeve urbane te gjeneruara nga punonjesit eshte 0.4 kg/dite per person.
- Objekti furnizohet me energji elektrike nga nje trasformator 20 kW qe eshte instaluar prane objektit, objekti eshte tokëzuar dhe i gjithë sistemi është i lidhur me kutinë qëndrore të shpërndarjes e cila është e siguruar me celësin e sigurisë, për çfardo lloj avarie të mundshme.
- Paisjet e reja jane me te avancuara dhe nje sere veprimesh i kane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet per mos nderhyrjen ne makineri gjate punes, stakimit te energjise para fillimit te kontrollit apo mirembajtjes e remontit te tyre, etj.



Nga puna ne Aktivitet



Procesi i pastrimit



Procesi i paketimit

Ndertesa administrative dhe e zhvillimit te Aktivitetit

Dimensionet dhe pamja e jashtme e objektit jane dhene ne formen grafike te projektit. Pjesa administrative dhe e zhvillimit te Aktivitetit jane parashikuar ne ndertesën 1 kat. Ne godine jane vendet per garderobe per punetoret, dhe nje dhome e vogel per ngrenie si dhe vendet sanitare me kabinat e dushit. Ne godine kemi zyra te drejtuesve si dhe nje salle e vogel per zhvillimin e mbledhjeve.

3.4 Pjesa elektroenergetike

Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi do te jete sipas kerkeses ne marreveshje me kompanine e furnizimit me energji elektrike. Ky plan i pergjithshem ka parashikuar qe furnizimi te jete nga SN bllok nga TS-(10MVA) me dy SN kabulla (sistem i hyrje/daljes).

Si burim rezerve i energjise (ne rastin e nderprerjes nga rrjeti primar) eshte parashikuar perdorimi i nje gjeneratori me naftë me kapacitet 630 KVA (ivendosur afer ndertesës se transformatorit). Gjeneratori sherben para se gjithash si burim rezerve per furnizim e pompave zjarri kesë. Kalimi ne furnizim me gjenerator eshte automatik. Si burim i veçante i energjise eshte parashikuar dhe UPS, e cila eshte e dedikuar per furnizim te sigurt te pajisjeve te kontrollit dhe te sinjalizimit te punes se pajisjeve, i cili ndodhet ne ndertesën kryesore administrative.

Stacioni i transformatoreve dhe gjeneratorit me naftë

Stacioni i transformatorit eshte pjesa kryesore e pajisjeve ne kuptimin e furnizimit me energji elektrike. Ne perzgjedhjen e vendndodhjes se tij, stacioni i transformatorit eshte i vendosur i tille qe te jete ne qender konsumimit afer konsumatoreve te medhenj, por eshte mbajtur parasysh qe ai duhet te jete jashte zonave te rrezikut nga zjarri dhe eksplozioni, e tille qe te mos pengoje aksesin dhe punen ne pajisje, si dhe qe hyrja ne pikat kyçe te tensionit te larte dhe te ulet te jete e kthyer kah pajisjet.

Kjokonsiston ne :

- dhoma me njesi 10(20)kV
- dy qeliza transformatori, me transformator nga 1000 kVA dhoma me kabinete te shperndarjes se tensionit te ulet hapësira kabllore nen hapësiren e tensionit te ulte dhe 10 kV.
- hapësirat e gjeneratorit me naftë 630kVA (mundesisht pa dhome- gjenerator i pozicionuar ne kontenier)

Ne menyre qe te behet e mundur fikja e konsumatoreve qe ndodhen ne zonat e rrezikuara nga zjarri dhe eksplozioni, ne raste emergjente eshte projektuar te behet nga butonat ESD (butonat me shtypje per fikje ne raste emergjence). Keto butona jane vendosur neper Aktivitet.

Instalimet per ndriçim

Ndriçimi eshte projektuar ne ate menyre qe te siguroj pune te sigurt te personelit duke respektuar kerkesat. Me rastin e caktimit te forces se ndriçimit, ne disa pjese te caktuar te objektit, duhet t'i permbahen kerkesave per ndriçim sipas prEN 12464-2-Lighting of outdoor work places.

Mbrojtja nga goditja e rrymes elektrike

Mbrojtja nga prekja direkte e pjeseve nen tension eshte arritur permes mbylljeve te siguresave. Mbrojtja nga prekja e rrezikshme e tensionit te larte (mbrojtja nga prekja indirekte) do te jete e arritshme permes çkyçjeve te shpejta te prishjeve elektrike, permes mbrojtjes mbi rrymore (sistemi i rrjetit eshte TN-S). Si mase shtese perdoret sistemi i barazimit te potencialit.

Shperndarja e kabullit

Tubat e kabullit lidhes SN ekzistues TS- (10MVA) do te jete i realizuar me kabull te tensionit te mesem per tensionin nominal 20kV (3x1xXHE 9 5 mm²), i cili do te shtrihet ne kanalin tokesor.


Tokezimi dhe mbrojtja nga rrufeja

Si tokezim do te shfrytezohet, shiriti prej bakri i gjerese 95 mm².

Tokezimi perforcohet ne thellesi 0,6- 0,8 m.

Per ndertesa eshte parashikuar tokezim ne themele nga shiritat e zinkuar, gjeresia 30 x 4 mm ose armatura e themelit.

Tokezimi ne themele duhet te saldohet ne konstruksionin e armatures.



Paisjet ventiluse ne aktivitet

3.5 Organizimi i punes dhe fuqia punetore

Puna brenda në objekt është e ndarë qartë, dhe secili prej punonjësve realizon ato procese pune për të cilat ai është ngarkuar nga përfaqësuesi i shoqërisë.

Në të punojnë rreth 14 punonjës, ne varesi të kërkesave të tregut.

Regjimi i punës do të jetë me 1 turn kur Shoqëria do të punojë me kapacitet të plotë. Punonjësit e punësuar kanë eksperiencë në kryerjen e proceseve të punes.

Per Menaxhimin e Aktivitetit dhe funksionimin e linjes së pastrimit dhe paketimit të produkteve të detit në një ditë të zakonshme pune, skema e funksionimit është shumë e thjeshtë dhe e mirë organizuar nga Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë "ARTIC GROUP" Sh.p.k. ecuria e punes është si më poshtë:

- Drejtuesit teknik menaxhojnë plotësisht të gjithë rrethin e punës së aktivitetit.
 1. Kontrollon në kohë reale ecurinë e variablave të Aktivitetit dhe paraqet në grafik visual aktivitetin në ore.
 2. Kontrollon dhe kordinon plotësisht proceset e aktivitetit dhe ofron informacione të vazhdueshme të ecurisë së aktivitetit.
- Lejon një gamë të gjerë të programeve të Aktivitetit nëpërmjet menaxhimit dhe trajtimit të operacioneve, të tilla si:
 - Menaxhimin e Produktit të furnizuar
 - Menaxhimin e përditshëm të produktit për pastrim.
 - Programet e mirëmbajtjes së makinerive dhe paisjeve
 - Ruan një skedar të operacioneve në aktivitet
- Drejtuesi Teknik kontrollon magazine frigoriferike dhe njofton për ato që ka më pak në gjendje.
- Punonjësit
 - Drejtojnë operacionet e pastrimit të paketimit
 - Mirembajnë, kontrollin dhe riparimin e linjes së instalimit/aparaturave

Kryerja e aktivitetit, gjithashtu, favorizohet nga:

- Pozicioni arkitektonik i aktivitetit dhe hapsira e bollshme në dispozicion për zhvillimin e të gjitha proceseve për pastrimin dhe paketimin të punojnë në grup me hapsira ndërmjet tyre të cilat nuk pengojnë proceset e njëra-tjetres.
- Distanca e objektit me zonat e banuara, duke mos ndikuar në aktivitetin e tyre bujqësor, ekonomik dhe shoqëror.
- Instalimet janë të një teknologjie bashkohore dhe të certifikuar dhe me ISO.

Avantazhet e aktivitetit tona janë ?

Në diskutim mund të përmendim disa avantazhe që na bëjnë edhe më të suksesshem:

1. Të pasurit e një eksperience në drejtim, organizim dhe prodhim nga sipërmarrësit dhe krijuesit e aktivitetit.
2. Ofrimi i konsulencës nga partnerët tanë në Itali, "Iberian Iceberg" srl.

3. Punesimi i teknikeve prodhues te huaj qe kane punuar ne pozicione te ngjashme ne disa vende te botes.
4. Implementimi i impianteve, makinerive dhe linjave te prodhimit sipas standarteve europiane qe rrisin eficensen dhe efikasitetin tone, por njekohesisht dhe cilesine.
5. Bashkepunimi me firmat me te mira Italiane nga te cilat sigurojme lenden e pare qe na nevojitet ne procesin tone te prodhimit.
6. Ofrimi i produkteve me cilesi te larte.
7. Krijimi i imazhit te mire duke punuar per kliente me te fuqishem ne industrine e ushqimit ne bote dhe restorantet me te njohura ne Shqiperi dhe jashte vendit.
8. Afersia me tregun nepermjet Detit Adriatik.

A. Disavantazhet tona

Askujt nuk i pelqen te permende disavantazhe por nese duam te jemi realiste me veten dhe te arrijme objektivat e synuar, ato jane pika kryesore qe duhet percaktuar. Per momentin disavantazhi i vetem mund te jete prania e konkurrenteve ne treg qe ofrojne çmime me te uleta por asnjehere te njejten cilesi me ne.

B. Ambienti i afert i biznesit.

Ne ambientin tone te afert bashkepunetoret tane me te rendesishem jane bashkepunetoret tane italiane ne fushen dhe industrine e ushqimit kryesisht ate te peshkut. Jane ata qe organizojne dhe drejtojne te gjitha proceset e punes qe duhen bere ne Shqiperi. Gjithashtu per sektorin tone rol te rendesishem ka Qeveria e cila me politikat e saj ligjore ndikon mjaft ne te gjithë kete zinxhir prodhues duke ia lehtësuar ose vështiresuar punen ketij sektori.

C. Ambienti i larget i biznesit.

Po ti referohemi ambientit te larget te biznesit atehere konkurrenca zgjerohet. Kjo sepse ne shume vende te Europes si ne Spanje, France, Gjermani shume kompani ushtrojne te njejtin aktivitet dhe ofrojne kushte terheqese per klientelen perendimore te tilla si kosto e ulet e prodhimit, prani dhe disponibilitet te larte te fuqise punetore , kosto te uleta te ngritjes dhe mbajtjes se reparteve te prodhimit etj.

Objektivat.

Ne synojme te realizojme keto objektiva:

1. Zgjerimin e reparteve tona prodhuese. Ne kemi marre disa makineri te reja te cilat i kemi instaluar ne impiantin tone prodhues dhe do t'i veme ne pune sapo te kemi fuqine punetore te nevojshme ne dispozicion.
2. Shtimin e numrit te fuqise punetore me 40 punetore te tjere. Punetoret do t'i kene vendet e punes te gatshme dhe do te instruktohen nga tekniket tane per kryerjen e procesit te punes. Nuk ka rendesi nese kane qene te papune per nje kohe te gjate apo futen ne pune per here te pare, apo jane pa eksperience. Ata do te trajnohen deri sa te jene te afte per kryerjen e punes qe do t'u ngarkohet.

3. Shtirirjen ne tregje me te gjera se aktualisht. Nese do te punesojme fuqine punetore shtese normalisht do te shtohet dhe prodhimi dhe do te mund te lidhim kontrata te reja me kliente nga e gjithë Europa .
4. Ulje te koston se prodhimit si rrjedhoje e rritjes se efektivitetit dhe eficences prodhuese. Kjo do te mundesohet nga makinerite shtese qe kemi marre si dhe nga fuqia punetore shtese qe do te trajnojne tekniket tane.
5. Rritje gjithnje e me teper te cilesise sone prodhuese. Trajnimi i punetoreve te rinj sipas nevojave tona te prodhimit do te na mundesoje nje cilesi gjithnje e me te mire te produktit tone.

Te gjitha keto do te na ndihmojne te perqendrohemi ne treg dhe te fuqizojme pozitrat tona.

Perfitimet Social – Ekonomike

Si pasoje e venies ne zbatim te projektit te menduar nga Subjekti yne per vitin 2016 e ne vazhdim mendojme se do te realizojme keto perfitime social – ekonomike:

1. Punesimin e personave qe kane qene te papune per nje afat te gjate.
2. Punesimin e grave e vajzave.
3. Punesimin e personave pa eksperience pune te meparshme.
4. Punesim te personave te cilet nuk kane nje diplome ose kualifikim.
5. Realizimin e te ardhurave familjare nepermjet punesimit.
6. Rritje te mireqenies shoqerore.
7. Permiresim te standartit te jeteses se familjeve ne veshtiresi.



Garderoba e punonjesve



Pamje e ambienteve per higjenizimin e punonjesve


4. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis dhe masat per minimizimin e tyre

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive te Aktivitetit "**Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve**". Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh.

Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular per pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.



Pamje e ujmbledhsit jashte godines

4.1 Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me gjate fazes operative se bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Çeshtjet e mjedisit te lidhura me Aktivitetin **“Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve”**. ne llogjiken e ciklit perfshijne:

4.1.1 Shkarkimet ne ujera

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Ujrat e gjeneruara nga aktiviteti
- b) Ujrat nga larja e ambientit te punes
- c) Ujrat e shiut
- d) Ujerat e perdorura per qellime sanitare.

Te gjitha ujrat e gjeneruara nga instalimet dhe aktiviteti sanitar ne objektin ku magazinohet pastrohet dhe paketohet produktet e detit grumbullohen nepemjet kanalizimeve te brendshme dhe dergohen ne vasken e dekantimit te ujrave, para shkarkimit te tyre ne rrjetin e kanalizimeve te zones.

Asgjesimi i mbetjeve jashte instalimit

Lenda e pare

Si lende te pare te impiantit te trajtimit te ujrave do te kosiderohen ujrat teknologjike qe vijne nga procesi teknologjik i perpunimit te peshkut ne fabriken prane impiantit.

Ne keto ujra bejne pjese:

- a) ujrat qe vijne nga procesi i pastrimit te produkteve te detit. Keto ujra mbartin papasterti dhe mbetje te ngurta qe shoqerojne gjallesat e detit.
- b) ujra te kripura —shellira qe perdoren ne procesin e kripezimit te peshkut -pjese e proesit teknologjik.
- c) ujrat qe perdoren per pastrimin e ambjenteve te punes gjate realizimit te procesit teknologjik.

Mbetjet

Ne kete proces te trajtimit te ujrave do te kemi disa lloj mbetjesh.

a) Mbetje -materiale te ngurta me permasa te medha.

Mbetje -materiale te ngurta me permasa te medha vijne nga grila e vendosur ne Dhomen e Hyrjes. Impianti eshte i pajisur me nje nyje te posaçme paratrajtuese qe pret te gjitha ujerat e prodhuara nga proceset e ndryshme ne fabrike, te cilat nuk jane te lidhur me sistemin e kanalizimeve qendrore. Ne fillim uji i ndotur i fabrikes hyn ne Dhomen e Hyrjes, me ane te nje tubacioni te vetem me diameter te jashtem 250 mm — me Presion 6 bar. Ne dhomen hyrese eshte vendosur nje grite e trashe e cila ben te mundur largimin e materialeve te ngurta me permasa te medha.

b) Mbetje te ngurta qe vijne nga pellgjet anaerobe

Pellgjet anaerobe bejne te mundur dekantimin e nje pjese te materialit te ngurte qe ndodhet ne ujerat e ndotura.

Trajtimi ne kete pellg onoerob sherben per.

1. Ndarjen e lendeve te ngurta nga faza e lenget, me ane te dekantimit te lendeve ne suspense ne fund te rezervuarit.
2. Grumbullimin e materialeve te patretshme dhe lendeve jo-te biodegradueshme.
3. Zberthimin e lendeve organike te biodegradueshme, nga mikroorganizmat anaerobe, ne nje llojshmeri produktesh perfundimtare (ku perqendrimin kryesor e ze CH₄, CO₂).
4. Biodegradimin e metejshem te lendeve organike.

c) Llumi qe vjen nga Dekantuesi Sekondar

Dekantuesi Sekondar, realizon dekantimin e lendeve te ngurta ne suspense. Ne Impiantin e Fabrikes dekantuesi sekondar ka forme rrethore vertikale, me pjerresi drejt qendres ku ndodh grumbullimi i llumit. Dekantuesi eshte i pajisur me nje strukture hyrese qendrore, nga e cila uji i trajtuar se bashku me biomasen dhe LNGP-te, rrjedh horizontalisht ne drejtim te ullukut mbledhes qe eshte i vendosur ne perimete te dekantuesi, ne pjesene siperme te tij.

Dekantuesi eshte i pajisur me nje urrerotulluese, ku jane instaluar kruajtes siperfaqesor dhe fundor.

Llumi nga grumbulluesi qendror ne forme hinke, largohet per tek dhoma e shperndarjes me ane te nje pompe llumite instaluar ne dhomen ngjitur.

d) Largimi i biomoses nga effluent (ujrat teknologjik te ose pa trajtuar)

Metoda me e perdorshme per largimin e biomoses nga effluent eshte sedimentimi gravitacional, i cili perdoret ne njesite funksionale biokimike perpara shkarkimit te effluentit. Meqenese bakteriet ne forma te vetmuara jane shume te vogla (0.5-1.0 μm), do te ishte e pamundur ti largoje ato me sedimentim neqoftese do te rriteshin individualisht. Fatmiresisht, nen kushtet te pershtatshme rritjeje, bakteriet ne kulturat me rritje ne shtrese te fiksuar rriten ne nje mase xhelatinoze mucilagjenoze, te cilat variojne ne permasa nga 0.05 ne 1.0 mm

e) Trajtimi i llumrave

Linja e trajtimit te llumit perbehet vetem nga njesia e grumbullimit te llumit qe perbehet nje rezervuar rrethor vertikal llumi qe vjen nga pellgu anaerob dhe nga dekantuesi sekondar transportohen per tek rezervuari i grumbullimit te llumit. Nga pellgu anaerob, llumi largohet dy here ne vit.

Largimi i llumit behet me anen e nje makinerie te posacme.

Asgjesimi i mbetjeve

Asgjesimi i mbetjeve realizohet me anen e trajtimit te llumit qe vjen nga njesia e grumbullimit te llumit, pellgu anaerob, dhe dekantuesi sekondar transportohen per tek rezervuari i grumbullimit te llumit, dhe nga pellgu anaerob, llumi largohet dy here ne vit

Largimi i llumit behet me anen e nje makinerie te posacme.

Produkti

Produkt do te konsiderohen ujrat teknologjike te dala nga fabrika e perpunimit dhe paketimit te peshkut, te pastruarane parametrat e kerkuara per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese.



Pamje e kapakeve te gropave per mbledhjen e llumrave

4.1.2 Ndotja e tokes

Nga procesi i "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve" nuk kemi ndotje te tokes, pasi i gjith procesi zhvillohet brenda objektit 1 KT dhe eshte totalisht i mbyllur. Ambientet jashte objektit jane te gjitha te shtruara me asfalt dhe nuk ekziston mundesia e ndotjes se tokes.

Paratrajtimi eshte njesia e pare trajtuese qe behet ujrave teknologjike perpara se ato te derdhen ne kaanlizimin e zones.. Ne kete njesi behet trajtimi mekanik i ujerave te ndotura duke larguar materialet e ngurta me permasa te medha.Paratrajtimi zakonisht eshte i perbere nga grilat, rerebledhesi dhe yndyrembJedhesi.

Dhoma e grilave. Nga dhoma e hyrjes uji transportohet per tek dhoma e grilave. Grilimi eshte faza e pare e trajtimit, gjate se ciles behet e mundur mbajtja dhe largimi i materialit te trashe. Kjo çon ne mbrojtjen e instalimeve te metejshme (tubacioneve, valvulave, pompave etj) dhe permiresimin e cilesise se llumit. Ne impJant eshte instaluar nje grite fine me hapsire 7 mm dhe trashesi te shufrave 6 mm. Per largimin e materialeve te mbajtura nga grila fine eshte instaluar nje kreher mekanik. Ne rast te mos funksionimit te grites uji i ndotur kalon ne nje kanal by-pass, ne te cilin eshte vendosur nje grille e trashe me hapesire 40 mm dhe nje grille fine me hapesire 7 mm. Largimi i materialit te trashe behet me anen e nje kreheri manual.

Mbetjeve qe vijne nga grilat ju largohet uji dhe me pas ato shkarkohen ne kontenier.

Me pas transportohen per tek venddepozitimi i mbetjeve urbane me autobot te specializuar.

4.1.3 Ndotja e ajrit

Nuk kemi ndotje te ajrit, Brenda objektit eshte instaluar linja e aspirimit e cila ben te mundur kapjen dhe asgjesimin e ketyre gazrave ne forme avulli.

4.1.4 Mbetjet e ngurta urbane

Si pasoje e proceseve te ndryshme qe ndodhin brenda objektit ku zhvillohet aktiviteti. Keto mbetje grumbullohen nga punonjesit e shoqerise dhe depozitohen ne venddepozitimin e caktuar, ku me pas i jepen subjekteve te licencuara per asgjesimin, riciklimin e metejshem te tyre.

4.1.5 Shkarkimet e zhurmes

Permbledhje e listes se burimeve te shkarkimit te zhurmes.

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikes se shkarkimit	Nr. Ref. i pajisjes qe gjeneron ndotje akustike	Presioni akustik' (dBA) duke ju referuar distances	Periudha e shkarkimit
3 Pompa Ne stacionin e pompimit	Ne impintine trajtimit te ujrave	Pompa	80-85 dB (A)	Gjate transportimit te ujit te ndotur te fabrikes per ne impiantin e pastrimit te ujrave
Shperndaresi me 4 krahe	Ne hyrjen e Efluentit ne filter	Elike me flete metalike	65-75 dB (A)6	Gjate kohes se Kalimit te efluentit ne filter

Ne impiant nuk kemi paisje qe gjenerojne zhurma qe te emetojne ndotje akustike ne mjediset rrotull. Paisjet qe emetojne zhurma ne ambientet e impiantit te trajtimit te ujrave jane vetem 3 pompa te cilat nuk i kalojne nivelin e 80-85 (Dba) Ne zonen e objektit objekte sociale si shkolla, spitale, etj jane relativisht larg dhe nuk ndikohen nga zhurmat e brendshme te impiantit.

Objekti eshte me destinacion perpunimi i ujrave teknologjike te fabrikes se perpunimit te peshkut.

Mjedisi	Efkti kritik ne shendet	eq Dba)	Koha Baze (ore)	LA + x rp (Dba)
Zone industriale ,	Demtimit Degjimi	70	24	110

- **Rastet aksidentale**

Jane marre masat per parandalimin e tyre, mjetet kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrikante apo karburant. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

- **Sigurimi teknik**

Mbrojta e shendetit dhe siguria ne pune jane ne qender te vemendjes te Shoqerise. Per te mbajtur nje regjim te forte te sigurise ne pune dhe shendetit te plote te punonjesve do te merren masat e meposhtme:


- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per punesim dhe *specialiste* te profesioneve qe kerkohen.

- Do të punesohen punonjes që kanë eksperiencë të gjatë në profesion.
- Masat për mbrojtjen nga zjarri do të jenë pjesë e instruksioneve dhe të tabelave lajmëuese dhe parandaluese.

Masat ndaj zjarrit

Mbrojtja ndaj zjarrit vlerësohet si një nga prioritetet kryesore të shoqërisë. Subjekti ka marrë masat ndaj zjarrit duke vendosur në vende të dukshme hidrantet kundër zjarrit si dhe tabelat sinjalizuese për mbrojtjen ndaj tij për një funksionim normal dhe pa avari të aktivitetit.

Në zbatimin e gërmes të nenit 34, të Ligjit Nr.8766 datë 05.04.2001 "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin", shoqëria ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen në raste rreziku të zjarrit. Për një siguri maksimale janë marrë të gjitha masat për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes nga zjarri.



Pamje e hidranteve për MNZ

Në territor janë vendosur në vende të dukshme pajisjet e mbrojtjes nga zjarri dhe janë marrë masa për të kryer instruksionin e punonjesve në mënyrë periodike. Për mbrojtjen nga Zjarri janë marrë masat e mëposhtme:

- Ka fikese zjarri sipas normave.
- Ka rregullore të brendshme të PMNZSH-se.
- Personeli është i instruktuar me rregullat e PMNZSH-se.

4.2 Identifikimi i masave për të eliminuar apo zbutur ndikimet negative në mjedis

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim

- Perdorimi i tokës: Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave dhënë në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
- Mbrojtja nga erozioni: Zbatimi rigoroz i masave teknike dhe higjienike për aktivitetin **“Trajtimi ose magazinim i peshqeve të ngordhur ose mbetjeve të peshqeve”**. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës.
- Cilesia e ajrit: Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së impiantit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
- Sistemi i drenazhimit: Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët dhe riciklimi i ujrave.
- Mbetjet: Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitim më të afërt të caktuar nga njësia vendore. Asgjësimi i mbetjeve që vijnë nga impianti, nga kompani të licensuara. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim në maksimum i mbetjeve.
- Ujrat e ndotura urbane: Trajtimi i ujrave të përdorura teknologjike, duke i deguar në vasken e dekantimit. Maksimizimi i përdorimit të ujit.
- Zhurmat: Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.

4.3 Masat lehtësuese që do të ndermerren gjatë funksionimit të Aktivitetit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese. Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e Aktivitetit. Ndikimet negative në mjedis gjatë zhvillimit të aktivitetit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë përmendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

1. Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes së pastrimit të produkteve të detit.
2. Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier të mjaftueshëm për mbetjet për numrin e punonjësve.
3. Rikuperimi, Riciklimi dhe Ripërdorimi i mbetjeve
4. Kapja e gazrave dhe grimcave të pluhurit
5. Menaxhimi sa më eficient i produktit.
6. Mirembajtja ndërrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtës së tyre.
7. Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti.
8. Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.

4.4 Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- Parandalimi i shkarkimeve te ujrave te pastrimit ne mjedis.
- Lidhur me mbetjet e grumbulluara te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara ose me subjektin e grumbullimit te mbetjeve urbane.
- Sasia magazinuese e produkteve te detit te mos i kaloje volumet e parashikuara ne freigorifera ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje siperfaqen ne rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.

4.4.1 Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitet:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen kontener për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Mbetjet te Rikuperohen, Riciklohen dhe Riperdoren perseri ne Aktivitet, ajo sasi e mbetjeve qe nuk mund te riciklohet te rikuperohet dhe te asgjeshohet nga subjekte te licensuara.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar në këtë Formular-Kërkese për tu paisur me Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem si gjatë fazës së Aktivitetit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike. Impiantet e nevojshme janë projektuar në përputhje me Ligjin e ri, nr.9379, datë 28-04-2005 “Për Eficencën Energjiesë”, kjo do të çojë në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me eficientë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për **“Trajtimi ose magazinim i peshqeve të ngordhur ose mbetjeve të peshqeve”** vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së godines që disponon në pronësi.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet, emetimin e gazeve, ujrave dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga Aktiviteti.
- Linja e paisjeve të instaluar në objekt, do të koluadohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficientës që kanë në kryerjen e operacioneve të **“Trajtimi ose magazinim i peshqeve të ngordhur ose mbetjeve të peshqeve”**.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujit të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjedisëve të gjebruara, një mundësi e mirë dhe për vaditje dhe shmangie të derdhjes së tyre në mjedis si dhe shmangie të përdorimit të ujit të pijshëm për vaditje. Mjedis i gjëlbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit në objektit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Eshtë ndertuar sistemi i drenazhimit të ujrave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Për të shmangur ndotjen e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga Ujërave të Ndotura Urbane të kësaj zone është realizuar lidhja me vaskën e dekantimit e cila bën dekantimin e ujërave të ndotura teknologjike.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë

pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek pajisjet apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.

- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në Aktivitet.

5. Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për **Aktivitetin "Trajtimi ose magazinim i peshqeve të ngordhur ose mbetjeve të peshqeve"** është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me Aktivitetin **"Trajtimi ose magazinim i peshqeve të ngordhur ose mbetjeve të peshqeve"** por, i pozicionuar në **Fshati Xhafzotaj, Autostrada Durres-Tirane, pranë mbikalimit të Fllakes, Njesia Administrative Xhafzotaj, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurie 159/79, Durres**

Ka nevojë për një monitorim të vazhdueshëm, jo vetëm në Aktivitet, por dhe në një zonë rreth 50 m për rreth Objektivit ku zhvillohet Aktiviteti.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të paisjeve të instaluar.
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së pluhurit dhe avujve të gazrave dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura teknologjike dhe urbane që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt.

Monitorimi dhe rekomandime

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohet nga institucionet administrative si AKM-ja, ISHMP dhe Ministria e Mjedisit etj.

Plani i monitorimit te ndikimit ne mjedis.

Meqenëse kemi të bëjmë me Aktivitetin "Trajtimi ose magazinim i peshqeve te ngordhur ose mbetjeve te peshqeve", kërkohet monitorimi i ajrit cilesise se ujrave.

Pra monitorimi do të konsistojë në matjen e parashikuar të indikatorëve mjedisor:

Nr	Elementi i Monitorimit	Frekuenca	Analiza	Përgjegjësi
1	Monitorim i gjithë shkarkimeve të ujrave që shkarkohen nga Aktiviteti	Periodike	Analize e plote. Parametrat kimike: nitrate, nitrite, BOD, COD, metale, hidrokarbure.	Firma
2	Monitorim i ajrit.	Vazhdueshëm	Ne pika te ndryshme te Aktivitetit	Firma
3	Monitorim i gazeve nga mjetet e transportit	Vazhdueshem	NOx, SOx, CO, CO2, O etj	Firma
4	Monitorim i gjendjes së paisjeve dhe mundësisë për shtimin e zhurmave në punë.	Vazhdueshëm	Aromat, temperature, pluhurat, Zhurmat dB(A)	Firma
5	Sasia e lendes se pare te perpunuar/konsumuar	Periodike	Sasiore	Firma
6	Sasia e produktit te pastruar, pakeluar	Vazhdueshem	Sasiore	Firma

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të projektit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm është bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

BAZUAR NË LIGJIN 10 440, DATE 7.7.2011 "PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS" AKTIVITETI "TRAJTIMI OSE MAGAZINIM I PESHQEVE TE NGORDHUR OSE MBETJEVE TE PESHQEVE" NUK KERKON VLERESIM TE NDIKIMIT NE MJEDIS SIPAS SHTOJCES I DHE II "PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS SË THELLUAR TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS DHE PROJEKTET QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS PARAPRAKE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS", PASI OBJEKTI ESHTË EKZISTUES , ME LEJE NDERTIMI, KU REFERUAR PIKES 2, TE NENIT 4, TE LIGJIT 10 440, DATE 07.07.2011 "PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS", KY AKTIVITET ESHTË I NDERTUAR DHE NUK KERKON TI NENSHTROHET PROCEDURESE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDISI".

PER SA ME LART SUBJEKTI "ARTIC GROUP"SH.P.K. ME AKTIVITETIN E TIJ "TRAJTIMI OSE MAGAZINIM I PESHQEVE TE NGORDHUR OSE MBETJEVE TE PESHQEVE" APLIKON PER TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TE TIPIT B, REFERUAR KREUT II, TE VENDIMIT NR. 419, DATE 25.6.2014, "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE TË POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE MJEDISI TË TIPAVE A, B DHE C, PËR TRANSFERIMIN E LEJEVE NGA NJË SUBJEKT TE TJETRI, TË KUSHTEVE PËR LEJET RESPEKTIVE TË MJEDISIT, SI DHE RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR SHQYRTIMIN E TYRE NGA AUTORITETET KOMPETENTE DERI NË LËSHIMIN E KËTYRE LEJEVE NGA QKB-JA" SIPAS SHTOJCES I, TE LIGJIT 60/2014, DATE 25.6.2014 "PER LEJET E MJEDISIT" (TE NDRYSHUAR) PER VEPRIMTARINE ME ID 7.7 "PRODHIMI I USHQIMEVE DHE PIJEVE DHE VEPRIMTARITE E LIDHURA ME TO", PIKA 7.7/f. "TRAJTIMI OSE MAGAZINIM I PESHQEVE TE NGORDHUR OSE MBETJEVE TE PESHQEVE".

REFERUAR KREUT II "PROCEDURAT PER SHQYRTIMIN E KERKESAVE DHE PERCAKTIMIN E KUSHTEVE PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B" PIKA1.DHE TE VENDIMIT NR. 419, SUBJEKTI "ARTIC GROUP" SH.P.K. APLIKON PER ZHVILLIMIN E DEGJESES ME PUBLIKUN, SIPAS PIKES 13 TE KREUT VI TE KETIJ VENDIMI.

Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise "ARTIC GROUP" SH.P.K.

Tomi ISMAILATI

